



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE

PËR GJIMNAZIN

LËNDËT:

“SOCIOLOGJI”

DHE

“FILOZOFI”

(PROVIM ME ZGJEDHJE)

VITI SHKOLLOR 2020 – 2021

KOORDINATOR: ASTRIT DAUTAJ

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
SOCIOLOGJIA	4
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	4
UDHËZIM I VEÇANTË.....	6
TEMATIKAT E PROGRAMIT TË SOCIOLOGJISË	9
REZULTATET E PRITSHME SIPAS TEMAVE PËRKATËSE.....	12
FILOZOFIA.....	26
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT	26
UDHËZIM I VEÇANTË.....	28
OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË PROGRAMIT TË FILOZOFISË	32
PËRMBAJTJA.....	34
PESHA SIPAS TEMAVE	37



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES PËR MATURËN SHTETËRORE

(Provim me zgjedhje)

LËNDA

SOCIOLOGJIA

dhe

FILOZOFIA

Koordinator: Astrit Dautaj

Viti shkollor 2020-2021

SOCIOLOGJIA

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Sociologjia”, përfshin konceptet më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndë. Ky program është bazuar në programin ekzistues të lëndës “Sociologjia”, të zhvilluar në klasën e 11-të të shkollave të mesme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të lëndës “Sociologjia”, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020-2021, përbën një dokument të vlefshëm për shkollën e mesme, për nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e konsultimit ose të vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

Programi orienton **nxënësit** për përvetësimin e materialeve kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Sociologjia”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi përmban informacionin e nevojshëm orientues për **mësuesit** e lëndës “Sociologjia” të shkollës së mesme, që do të përgatisin maturantët për provimin e kësaj lënde me zgjedhje në Maturën Shtetërore.

Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga **specialistët e vlerësimit**, të përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Sociologjia”, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesuara.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës “Sociologjia” të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program**. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përmbajnë njohuri dhe koncepte të parashikuara në programin lëndor dhe të trajtuara në tekstet e mësimorë.

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Sociologjia” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e

përzgjedhur, por që përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Sociologjia” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektivi të caktuar të programit, atëherë **mësuesi** i lëndës, **që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të porealizuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Sociologjia”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “Sociologjia”.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e sociologjisë**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:
 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

Të identifikosh do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., ministrat) ose jo të prekshme (p.sh., koncepte, të tilla si: drejtësia, barazia etj.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj.

Të përshkruash do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj.

Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara.

Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike.

Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.

Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri.

Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

- me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;

- me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
- me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

TEMATIKAT E PROGRAMIT TË SOCIOLOGJISË

Kultura, individi, shoqëria

Kultura ose sistemi kulturor i çdo shoqërie është një dukuri shumë komplekse, e cila ndikon dhe shprehet në të gjitha modelet e sjelljes së anëtarëve të saj. Çdo sistem kulturor ka veçoritë e veta specifike, që shfaqen në pesë përbërësit kryesorë: simbolet kulturore, gjuha, vlerat kulturore, normat kulturore dhe kultura materiale. Njohja e veçorive specifike të sistemeve kulturore jo vetëm që i bën të vetëdijshëm anëtarët e kulturës për rëndësinë e kulturës përkatëse, por edhe i ndihmon të orientohen më mirë në sistemet e tjera kulturore. Një aftësim i tillë orientues bëhet gjithnjë e më i domosdoshëm, ndërkohë që në kushtet e përforcimit të prirjeve globalizuese rritet numri dhe pesha specifike e njerëzve që, për arsye të ndryshme, punojnë e jetojnë në disa sisteme kulturore (p.sh., rreth 27 për qind e popullsisë së Republikës së Shqipërisë aktualisht punon e jeton si emigrante në sisteme të tjera kulturore).

Shoqërizimi

Shoqërizimi është një proces mjaft kompleks. Nëpërmjet shoqërizimit, çdo njeri formon personalitetin e vet si njeri, profesionist, veprimtar shoqëror etj. Çdo fazë e shoqërizimit të individit ndikohet nga faktorë dhe mjedise social-kulturore të ndryshme, të cilët evoluojnë në rrjedhën e kohës dhe përgjatë cikleve të shoqërizimit të çdo individi.

Devianca

Sjellja deviante është dukuri komplekse, e konstatuar në të gjitha shoqëritë dhe në të gjitha kohërat. Sjellja deviante ushtron ndikim të shumëllojshëm në dukuritë e proceset shoqërore, në zhvillimin e shoqërisë. Me qëllim që sjelljet deviante të jenë sa më pak problematike, është e nevojshme që nxënësi adoleshentë t'i njohë ato dhe shpjegimet e tyre sociologjike, sidomos në shoqërinë shqiptare.

Shtresimi gjinor dhe familja

Dallimet gjinore janë të pranishme pothuajse në të gjitha shoqëritë. Ndonëse kryejnë role plotësuese të domosdoshme për funksionimin normal dhe zhvillimin e shoqërisë, marrëdhëniet ndërmjet femrave dhe meshkujve jo rrallë karakterizohen nga diskriminimi. Zbehja dhe

tejkalimi i dukurive të tilla negative ndikojnë në harmonizimin e marrëdhënieve ndërmjet bashkëshortëve dhe përgjithësisht të anëtarëve të familjes, në pakësimin e divorceve e të anëve të errëta të jetës familjare etj.

Raca dhe etniteti

Fjala *etni* dhe sidomos fjala *racë* përdoren dendur në jetën e përditshme. Shpesh këto fjalë përdoren me kuptime të gabuara dhe krijojnë pështjellim rreth grupimeve të popullsisë që shënojnë. Për racat dhe etnitë, dhe sidomos për marrëdhëniet ndërmjet tyre, lënda e sociologjisë ofron kuptime të sakta, të cilat i ndihmojnë nxënësit adoleshentë të bëhen të vetëdijshëm, jo vetëm për të mos rënë në kurthin e paragjykimeve racore apo etnike, por edhe për t'u bërë veprimtarë shoqërorë për komunikime e marrëdhënie sa më harmonike ndërmjet grupimeve shoqërore me përkatësi të ndryshme racore dhe etnike.

Analiza sociologjike e besimeve fetare

Besimet fetare kanë qenë dhe janë të pranishme në të gjitha shoqëritë e studiuara deri në ditët tona. Ato paraqiten në forma të ndryshme dhe ndryshojnë në rrjedhën e kohës. Besimet fetare kanë kryer dhe kryejnë funksione të rëndësishme në shoqëri, ndaj dhe janë bërë një objekt i rëndësishëm i shqyrtimeve sociologjike.

Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara

Urbanizimi është një dukuri komplekse, e cila është përhapur dhe zhvilluar me ritme të shpejta përgjatë dy shekujve të fundit, duke përcaktuar ndryshime rrënjësore jo vetëm në peizazhin urban, por edhe në modelet e organizimit dhe të punës, të sjelljes dhe të të menduarit të shumicës dërrmuese të anëtarëve të shoqërisë. Në shoqëritë industriale shumë të zhvilluara ose pasindustriale puna ka disa karakteristika kryesore të cilat, në mjaft aspekte, dallohen nga veçoritë e punës në shoqërinë shqiptare. Të rinjtë shqiptarë lipset t'i njohin këto karakteristika, duke qenë se gjatë procesit të integritit në sistemin e ekonomive industriale të Europës e më gjerë, edhe ekonomia shqiptare do të formësohet shkallë-shkallë sipas modelit të tyre edhe në çështje të punës.

Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore

Shoqëria nuk është një grumbullim njerëzish të paorganizuar. Së paku, që nga lashtësia klasike greke e romake çdo shoqëri është e përbërë nga grupime shtresore të caktuara, si: kasta, klasa,

shtresa shoqërore etj. Çdo shoqëri ndryshon edhe në sajë të përpjekjeve të njerëzve për të ndryshuar statusin e tyre në shoqëri, në sajë të përpjekjeve për të kaluar nga klasat ose shtresat me status më të ulët në ato me status më të lartë. Në periudha historike të caktuara, përpjekje të tilla për ndryshim statusesh shoqërore masivizohen, bëhen më të vetëdijshme dhe më të organizuara, duke u shndërruar në lëvizje shoqërore.

Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne

Shoqëritë ndryshojnë vazhdimisht në rrjedhën e kohës. Ndryshime të rëndësishme janë vërejtur përgjatë kalimit të shoqërive nga faza tradicionale, në atë moderne dhe pasmoderne. Një tablo e përmbledhur e karakteristikave kryesore të shoqërive në këto tri faza të zhvillimit jepet në mësimet e kësaj linje. Analizat përgjithësuese konkretizohen edhe me fakte e dukuri nga shoqëria shqiptare.

Metodat e kërkimit sociologjik

Metodat e kërkimit sociologjik janë të shumëllojshme. Ato luajnë rol të pazëvendësueshëm për qëmtimin e fakteve shoqërore, për zbulimin e prirjeve të zhvillimit të dukurive e të proceseve shoqërore. Metodat e kërkimit sociologjik zbatohen “të modifikuara” sipas veçorive specifike të çdo shoqërie.

REZULTATET E PRITSHME SIPAS TEMAVE PËRKATËSE

TEMATIKA 1: Kultura, individi, shoqëria

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Kultura Individi Shoqëria	<p data-bbox="587 383 703 416">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="639 443 1390 1944" style="list-style-type: none"><li data-bbox="639 443 1299 477">• shpjegon konceptin gjithëpërfshirës të kulturës;<li data-bbox="639 524 1390 613">• përshkruan funksionet e kulturës në marrëdhëniet e njerëzve me natyrën, me njëri-tjetrin, me shoqërinë;<li data-bbox="639 660 1390 808">• tregon kuptimin e simbolit kulturor, funksionet kryesore të simboleve kulturore dhe veçoritë kryesore të zhvillimit të tyre;<li data-bbox="639 855 1390 1003">• dallon simbole të veçanta të kulturës shqiptare, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në funksionimin e shoqërisë shqiptare;<li data-bbox="639 1050 1390 1140">• përshkruan kuptimin e gjuhës si tërësi simbolesh kulturore;<li data-bbox="639 1187 1390 1335">• përshkruan rolin e veçantë të gjuhës shqipe në shpjegimin e disa dukurive kulturore e gjuhësore të vendeve të tjera të Evropës;<li data-bbox="639 1382 1390 1471">• tregon kuptimin e konceptit sociologjik të vlerave kulturore,<li data-bbox="639 1518 1390 1552">• përmend disa vlera kryesore të kulturave perëndimore;<li data-bbox="639 1599 1390 1747">• argumenton rolin e veçantë të vlerave kulturore të besës dhe të mikpritjes së shoqërisë tradicionale shqiptare;<li data-bbox="639 1794 1390 1942">• shpjegon konceptin sociologjik të normave kulturore dhe shumëllojshmërinë e tyre; argumenton raportet ndërmjet normave kulturore dhe normave ligjore;

	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon rolin e veçantë të normave kulturore në funksionimin e shoqërisë tradicionale shqiptare; • përcakton konceptin sociologjik të nënkulturës dhe kundërkulturës; • argumenton se kultura shqiptare është mozaik nënkulturash dhe e zhvilluar në periudha të gjata kohore si kundërkulturë; argumenton dhe ilustron me shembuj e fakte të qëmtuara nga jeta e përditshme; • dallon vështirësitë kryesore (etnocentrizmi, ksenocentrizmi) me të cilat ndeshen njerëzit kur kalojnë nga njëri sistem kulturor te tjetri; • përshkruan veçoritë kryesore të reagimit të shqiptarëve ndaj kulturave të tjera kryesisht nëpërmjet njohjes së përvojave jetësore të emigrantëve shqiptarë, të studentëve shqiptarë që studiojnë në vende të tjera; • përshkruan rëndësinë teorike dhe praktike të relativitetit kulturor. • përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit; • përgatit një ese për një çështje të kulturës shqiptare.
--	--

TEMATIKA 2: Shoqërizimi

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Shoqërizimi	<p data-bbox="592 349 703 383">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1756" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 533">• shpjegon kuptimin sociologjik të shoqërizimit në formimin e personalitetit të njeriut;<li data-bbox="592 555 1393 757">• jep disa shpjegime kryesore sociologjike të procesit të shoqërizimit (vetja shoqërore dhe marrja e rolit të tjetrit sipas xh. H. Mid, pikëpamja e Ç. H. Kult për shoqërinë si pasqyrë etj.);<li data-bbox="592 779 1393 981">• shpjegon ndikimet e veçanta të mjedisëve dhe faktorëve të ndryshëm (familja, shkollimi, grupet e vogla të shoqeve dhe shokëve më të afërt, mjetet e komunikimit masiv, opinioni publik);<li data-bbox="592 1003 1393 1093">• përshkruan veçoritë e ndikimit të faktorëve të tillë në shoqërinë shqiptare të ditëve tona.<li data-bbox="592 1115 1393 1261">• përshkruan ndikimin e filmave me procese gjyqësore dhe me dhunë në procesin e shoqërizimit të adoleshentëve shqiptarë;<li data-bbox="592 1283 1393 1429">• përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërizimit në ciklet e jetës (fëmijëria, adoleshenca, mosha e rritur e hershme, mosha e pjekurisë dhe pleqëria);<li data-bbox="592 1451 1393 1541">• analizon veçoritë e shoqërizimit përgjatë cikleve të tillë të jetës në shoqërinë shqiptare.<li data-bbox="592 1563 1393 1756">• përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi, duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

TEMATIKA 3: Devianca

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Devianca	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• përshkruan e arsyeton karakterin relativ të sjelljeve deviante, faktorët dhe rrethanat socialkulturore kryesore që përcaktojnë nëse një model sjelljeje është deviant ose jo;• përshkruan pesë tipat kryesorë të krimit (krimi kundër personit, krimi kundër pasurisë, krimi i urrejtjes ose i mërisë, krimi i “jakave të bardha” dhe i ashtuquajtur “krimi pa viktima”);• dallon format specifike të shfaqjes së krimeve të tilla në shoqërinë shqiptare të ditëve tona;• arsyeton prirjet përse meshkujt dhe të rinjtë janë më të kriminalizuar se femrat dhe burrat me moshë më të pjekur si në vendet e tjera, ashtu edhe në Republikën e Shqipërisë;• shpjegon ndikimet e filmave me dhunë dhe procese gjyqësore në modelet e sjelljes së të rinjve shqiptarë;• përshkruan si ndikojnë në sjelljet e atij filma të tillë;• përshkruan shpjegimet kryesore biologjike dhe gjenetike të deviancës;• shpjegon teorinë sociologjike të kontrollit të Trevis Hirshit dhe teorinë e etiketimit të Hauërd S. Beker për shpjegimin e deviancës;• shpjegon kuptimin e deviancës parësore dhe dytësore;• përshkruan funksionet kryesore shoqërore të sjelljeve deviante (pohimi i vlerave kulturore më të rëndësishme, përcaktimi i kufijve moralë, forcimi i unitetit shoqëror, faktor i rëndësishëm ndryshimesh shoqërore);• përshkruan veçori të funksioneve të tilla në shoqërinë shqiptare;

- përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;
- përgatit një ese për një sjellje deviante që shqetëson më shumë të rinjtë adoleshentë.

TEMATIKA 4: Shtresimi gjinor dhe familja

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Shtresimi gjinor dhe familja	<p data-bbox="592 349 703 383">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1989" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 533">• përshkruan format kryesore të shfaqjes së pabarazisë gjinore;<li data-bbox="592 555 1393 701">• përshkruan rolin e veçantë të vajzave dhe grave në shoqërinë shqiptare si faktor që përmirëson komunikimin, si faktor ekuilibrimi në jetën politike etj.;<li data-bbox="592 723 1265 757">• rendit objektivat kryesore të lëvizjeve feministe;<li data-bbox="592 779 1393 925">• dallon format kryesore të martesës (endogamia dhe ekzogamia, monogamia dhe poligamia) dhe përshkruan funksionet shoqërore të tyre;<li data-bbox="592 947 1393 1037">• rendin pikëpamjet kryesore për dilemën bashkëkohore: martesë apo bashkëjetesë;<li data-bbox="592 1059 1393 1149">• përshkruan mendësitë kryesore të shoqërisë shqiptare për këtë dilemë;<li data-bbox="592 1171 1082 1205">• rendit format kryesore të familjes;<li data-bbox="592 1227 1377 1261">• përshkruan karakteristikat kryesore të familjes shqiptare;<li data-bbox="592 1283 1393 1429">• shpjegon funksionet kryesore të familjes (shoqërizimi, rregullimi i marrëdhënieve seksuale, riprodhimi dhe nxitja emocionale e përkrahja ekonomike);<li data-bbox="592 1451 1393 1541">• përshkruan veçoritë e funksioneve të tilla në shoqërinë shqiptare;<li data-bbox="592 1563 1393 1653">• shpjegon dukurinë e divorcit dhe rrjedhojat shoqërore e psikokulturore të saj;<li data-bbox="592 1675 1337 1709">• përshkruan veçoritë e divorcit në shoqërinë shqiptare;<li data-bbox="592 1731 1353 1765">• parashtron vizionet kryesore për të ardhmen e familjes.<li data-bbox="592 1787 1393 1989">• përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit;

TEMATIKA 5: Racat dhe etniteti

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Racat dhe etniteti	<p data-bbox="592 349 703 383">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1312" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 533">• shpjegon kuptimin sociologjik të konceptit <i>racë</i>, <i>etnitet</i>, <i>pakicë kombëtare</i> dhe <i>pakicë etnike</i>;<li data-bbox="592 555 1393 645">• përshkruan paragjykimet dhe diskriminimet të formuara mbi baza racore dhe etnike;<li data-bbox="592 667 1393 813">• argumenton pse marrëdhëniet ndërmjet grupeve racore dhe etnike shpesh karakterizohen nga forma të ndryshme paragjykimi dhe diskriminimi;<li data-bbox="592 835 1393 981">• analizon katër format kryesore të marrëdhënieve ndërmjet shumicës dhe pakicave etnike në shoqëritë moderne (pluralizmi, asimilimi, veçimi (vetveçimi) dhe shfarosja);<li data-bbox="592 1003 1393 1093">• përshkruan veçoritë e marrëdhënieve të shqiptarëve me pakicat kombëtare ose etnike në vendin tonë;<li data-bbox="592 1115 1393 1312">• përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

TEMATIKA 6: Analiza sociologjike e besimeve fetare

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Analizë sociologjike e besimeve fetare	<p data-bbox="592 349 703 383">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1758" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 477">• analizon përcaktimet kryesore sociologjike të fesë;<li data-bbox="592 499 1393 696">• përshkruan funksionet kryesore të besimeve fetare (forcimi i unitetit shoqëror; përcaktimi i kuptimit të jetës; faktor i kontrollit shoqëror; ndikime të karakterit shoqëror të të shenjtës);<li data-bbox="592 719 1393 808">• përshkruan si shfaqet veprimi i funksioneve të tilla në bashkësinë vendore ku jeton ai vetë ose të afërm të tij;<li data-bbox="592 831 1393 976">• analizon ndikimin e shumëllojshmërisë fetare ndër shqiptarë në pasurimin e mozaikut nënkulturor të kulturës shqiptare;<li data-bbox="592 999 1393 1144">• përshkruan fakte që provojnë tolerancën, mirëkuptimin ndër fetar të shqiptarëve në ditët tona dhe në të kaluarën, së paku të afërt;<li data-bbox="592 1167 1393 1368">• përshkruan tipat kryesorë të organizatave fetare (eklesia, dinominejshën, sekti dhe kulti), ndryshimin e tyre në rrjedhën e kohës si shprehje e shndërrimeve politike e shoqërore;<li data-bbox="592 1391 1393 1536">• përshkruan veçoritë kryesore të 6 feve që konsiderohen fe botërore dhe funksionet e tyre shoqërore të veçanta në shoqëritë ku veprojnë;<li data-bbox="592 1559 1393 1758">• analizon prirjet kryesore të ndryshimit të besimeve fetare në shoqëri (shekullarizimi, laicizmi dhe fundamentalizmi); përshkruan veçoritë e shekullarizimit dhe të fundamentalizmit në shoqërinë shqiptare;

TEMATIKA 7: Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
<p>Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan parakushtet e urbanizimit dhe karakteristikat e qyteteve paraindustriale; • përshkruan veçoritë e urbanizimit përgjatë periudhës së industrializimit; • analizon dukuritë e prirjet kryesore të zhvillimeve urbane pas Luftës së Dytë Botërore (shpërqendrimi urban, zona urbane, përtëritje urbane, xhentrifikimi, eksurbanizim); • përshkruan karakteristikat kryesore të urbanizimit në Shqipëri, veçanërisht pas Luftës së Dytë Botërore; • përshkruan interpretimet kryesore sociologjike të jetës shoqërore në qytete (dallimet e mënyrës urbane të jetesës nga mënyra rurale, urbanizimi si mënyrë jetese dhe ekologjia urbane); • analizon karakteristikat kryesore të punës në shoqëritë më të urbanizuara ose më të industrializuara (pakësimi i punës së gjallë të njerëzve në bujqësi; rritja e peshës specifike të punëve “jakëbardhë”, shtimi i profesioneve shumë të kualifikuara dhe rritja e rëndësisë së tyre; pakësimi i peshës specifike të të vetëpunësuarve; papunësia; ekonomia e paligjshme; rritja e shkallës së diversitetit në vendin e punës; rritja e shkallës së përdorimit të teknologjive të informacionit); • krahason përafrimet, dallimet dhe karakteristikat e kundërta të punës në shoqërinë shqiptare të ditëve tona dhe rrjedhojat e tyre; • përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi, duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

TEMATIKA 8: Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ përshkruan karakteristikat kryesore të shtresimit shoqëror;▪ përshkruan karakteristikat kryesore të organizimit të shoqërisë në sistemin e kastave;▪ përshkruan karakteristikat kryesore të organizimit të shoqërisë në sistemin e klasave;▪ analizon dukurinë e lëvizshmërisë shoqërore individuale e strukturore dhe veçoritë e tyre në sistemin e kastave e të klasave;▪ analizon veçoritë kryesore të klasave e shtresave në shoqërinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, si një nga shoqëritë e mëdha më të urbanizuara;▪ analizon dukurinë e ndryshimit shoqëror dhe karakteristikat kryesore të tij (i përgjithshëm dhe me veçori dalluese në çdo shoqëri; përgjithësisht i qëllimshëm, por i paplanifikuar në të gjithë rrjedhojat; rrjedhoja kontradiktore dhe kohëzgjatje të ndryshme);▪ interpreton idetë sociologjike për lëvizjet shoqërore dhe trupat kryesore të lëvizjeve shoqërore (lëvizja alternative, lëvizje realizuese, lëvizja reformuese dhe revolucione);▪ analizon veçoritë e lëvizjeve shoqërore në të katër fazat e zhvillimit të saj dhe arsyet kryesore të rënies së lëvizjes shoqërore.

TEMATIKA 9: Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne	<p data-bbox="592 349 703 383">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1529" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 745">• përshkruan katër karakteristikat kryesore të shoqërisë moderne sipas Peter Bergerit (venitja e komuniteteve të vogla tradicionale; zgjerimi i mundësive për zgjedhje vetjake; zgjerimi i spektrit të shumëllojshmërisë shoqërore; orientimi nga e ardhmja dhe rritja e vetëdijes së kohës);<li data-bbox="592 775 1393 857">• përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë tradicionale të krahasuara me ato të shoqërisë moderne;<li data-bbox="592 887 1393 1025">• përshkruan karakteristikat kryesore të shoqërisë tradicionale shqiptare dhe dukuritë e prirjet kryesore të modernizimit të një shoqërie të tillë;<li data-bbox="592 1055 1393 1305">• analizon e interpreton pesë karakteristikat kryesore të shoqërisë pasmoderne (rënia e modernitetit; zbehja e dritës së përparimit; shkenca nuk përballon zgjidhjen e çështjeve; intensifikimi i debateve kulturore; ndryshimi i vazhdueshëm i institucioneve shoqërore).<li data-bbox="592 1335 1393 1529">• përgatit një detyrë analitike sipas temave të përcaktuara në tekst ose që i përcakton mësuesja/mësuesi duke pasur parasysh veçoritë e qytetit ose të krahinës ku jetojnë nxënësit.

TEMATIKA 10: Metodatat e kërkimit sociologjik

Tema	Rezultatet e pritshme të të mësuarit
Metodat e kërkimit sociologjik	<p data-bbox="592 349 703 376">Nxënësi:</p> <ul data-bbox="592 443 1393 1984" style="list-style-type: none"><li data-bbox="592 443 1393 533">• përshkruan karakteristikat kryesore të metodave të kërkimeve sociologjike;<li data-bbox="592 555 1393 701">• përshkruan disa eksperimente sociologjike (eksperimenti në fabrikën Hawthorne dhe eksperimenti në burgun Stanfordd);<li data-bbox="592 723 1393 813">• krahason përparësitë e kufizimet e një metode të kërkimit sociologjik;<li data-bbox="592 835 1393 925">• përshkruan reagimet e veçanta të shqiptarëve nëse vihen në një situatë eksperimentale;<li data-bbox="592 947 1393 1261">• përshkruan llojet kryesore të vëzhgimeve sociologjike (vëzhgimi i pjesshëm dhe i përgjithshëm, vëzhgim sistematik dhe jo sistematik, vëzhgim i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë, vëzhgim pjesëmarrës dhe jo pjesëmarrës) dhe procedurën e realizimit të tyre në kushtet e shoqërisë shqiptare;<li data-bbox="592 1283 1393 1373">• përdor elementet kryesore të hartimit dhe të realizimit të anketës sociologjike;<li data-bbox="592 1395 1393 1541">• harton dhe realizon modele ankete sociologjike, duke pasur parasysh veçoritë e modelimit psikokulturor të shqiptarëve;<li data-bbox="592 1563 1393 1709">• përdor kriteret dhe kërkesat kryesore të kampionimit sociologjik, për të realizuar praktikisht kampionime sociologjike të thjeshta;<li data-bbox="592 1731 1393 1877">• përshkruan llojet kryesore të intervistave sociologjike (intervista e lirë, intervista e strukturuar dhe intervista gjysmë e strukturuar);<li data-bbox="592 1899 1393 1989">• realizon intervista të thjeshta, duke pasur parasysh veçoritë kryesore të formimit psikokulturor të shqiptarëve;

- përdor dokumente të ndryshme zyrtare dhe vetjake në studimet sociologjike në shoqërinë shqiptare;
- përdor për të lexuar dhe interpretuar nga pikëpamja sociologjike dokumente të ndryshme zyrtare ose vetjake;
- harton një anketë që synon të studiojë një problem rinor të adoleshencës;
- interpreton të dhënat e grumbulluara përmes një ankete të realizuar me nxënësit e klasës ose të shkollës (mund të realizohet edhe si punë në grup).

PESHA SIPAS TEMAVE

Nr.	Tema	Pesha (në përqindje)
1.	Kultura, individi, shoqëria	13%
2.	Shoqërizimi	9%
3.	Devianca	11%
4.	Shtresimi gjinor dhe familja	11%
5.	Raca dhe etniteti	9%
6.	Analiza sociologjike e besimeve fetare	10%
7.	Urbanizimi dhe karakteristikat e punës në shoqëritë më të urbanizuara	11%
8.	Shtresimi i shoqërisë dhe lëvizjet shoqërore	9%
9.	Shoqëria tradicionale, moderne, pasmoderne	7%
10.	Metodat e kërkimit sociologjik	10%
Totali:		100%

FILOZOFIA

UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues për lëndën me zgjedhje “Filozofi”, përfshin koncepte më të rëndësishme të lëndës, si dhe njohuritë dhe shprehjet themelore që synohen në këtë lëndë. Ky program është bazuar në programin ekzistues të lëndës “Filozofi”, të zhvilluar në klasën e 12-të të shkollave të mesme.

Programi orientues për provimin me zgjedhje të filozofisë, i vlefshëm për provimet me zgjedhje në kuadrin e Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2020-2021, përbën një dokument të vlefshëm për shkollën e mesme, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e vlerësimit për provimet e Maturës Shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm orientues për mësuesit e lëndës “Filozofi” të shkollës së mesme, që do të përgatisin maturantët për provimin e filozofisë, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për përvetësimin e materialeve kyçe mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Filozofi”, si lëndë me zgjedhje në Maturën Shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Filozofi”, si lëndë me zgjedhje për Maturën Shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesuara.

Kujdes i veçantë duhet bërë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe të tezës së provimit të lëndës “Filozofi”, të cilët **nuk duhet të përfshijnë për vlerësim çështje mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program.** Banka e pyetjeve dhe teza e provimit të përmbajnë njohuri dhe koncepte të trajtuara në tekstet e vendosura për këtë provim (shih më poshtë).

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Filozofi”, t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk parashikohen në program, por që përmbajnë

informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e filozofisë të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve ekonomike e filozofike dhe të shprehive të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektivi të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në lëndën “Filozofi” do të ndërtohet duke u bazuar në kërkesat dhe objektivat e programit të lëndës “Filozofia 12”.

Testi synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e filozofisë, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e filozofisë në shkollë, të tilla si:
 1. **Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët intelektual).**
 2. **Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar intelektual).**
 3. **Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë intelektual).**

Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., filozofët) ose jo të prekshme (p.sh., koncepte, të tilla si: njohja, materia, ideja etj.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj. Për shembull, nxënësi të identifikojë (dallopjë) periudhat kryesore të zhvillimit të mendimit filozofik.
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj. Për shembull, nxënësi të përshkruajë historinë e mendimit filozofik përmes përfaqësuesve të saj;

Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- Të **shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p. sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për

ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara. Për shembull, nxënësi të shpjegojë lidhjen e një rryme, të një pikëpamjeje ose të një qëndrimi filozofik me faktorë historikë (ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, fetarë etj.)

- Të **analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike ose ekonomike. Për shembull, nxënësi të analizojë e të vlerësojë kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj., në kohë dhe në hapësirë;

Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- Të **vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj.
- Të **marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri. Për shembull, nxënësi të formulojë pikëpamjen e tij dhe të argumentojë pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik.
- Të **mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd. Për shembull, nxënësi formulon dhe mbron me argumente qëndrimin e tij në lidhje me një çështje të caktuar filozofike, duke mbajtur parasysh edhe argumentet e tjera.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli u ulët	Niveli mesatar	Niveli lartë
Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

- me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
- me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
- me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

1. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- Për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

3. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të eseve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHËM TË PROGRAMIT TË FILOZOFISË

Në fushën e njohurive

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të përshkruajë zhvillimin, evoluimin e mendimit filozofik, sipas periudhave historike;
- të dallojë periudhat kryesore të zhvillimit të mendimit filozofik;
- të përshkruajë karakteristikat kryesore të periudhës që lidhen me zhvillimin e filozofisë;
- të përshkruajë historinë e mendimit filozofik përmes përfaqësuesve të saj;
- të dallojë e të argumentojë lidhjen e disa prej koncepteve dhe problemeve kryesore të filozofisë me periudhat kryesore të mendimit filozofik në shekuj etj.;
- të dallojë pikëpamjet e kundërta ose të ndryshme në historinë e mendimit filozofik dhe të përshkruajë dallimet dhe pikat e përbashkëta.

Historicizmi dhe lidhja e kushtëzimi reciprok

Nxënësi duhet të vlerësojë rrymat, mendimin dhe pikëpamjet filozofike, historike etj., në kohë dhe në hapësirë. Për këtë, ai duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë tiparet thelbësore të periudhës historike, së cilës i përket një pikëpamje ose qëndrim filozofik;
- të shpjegojë lidhjen e një rryme, të një pikëpamjeje ose të një qëndrimi filozofik me faktorë historikë (ekonomikë, shoqërorë, politikë, kulturorë, fetarë etj.);
- të analizojë e të vlerësojë kufizimet ose vlerat e filozofëve, të mendimtarëve, të historianëve etj., në kohë dhe në hapësirë;
- të tregojë dhe të argumentojë rolin e filozofisë në përparimin e fushave ose aspekteve të ndryshme të jetës shoqërore e shkencore;
- të dallojë e të përshkruajë ndikimin e mendimit të përparuar botëror në mendimin filozofik në Shqipëri në periudha të ndryshme historike.

Ndryshimi dhe vazhdimësia

Nxënësi duhet të kuptojë procesin e ndryshimit dhe të vazhdimësisë së mendimit filozofik dhe të shpjegojë arsyen e ndryshimit dhe të vazhdimësisë.

- Të dallojë ndryshimet dhe vazhdimësinë historike dhe të tregojë si këto kanë ndikuar në zhvillimin ose ndryshimin e pikëpamjeve filozofike.
- Të dallojë tiparet kryesore të shoqërisë së sotme dhe të argumentojë vazhdimësinë e mendimit filozofik.

Krijimi i mendimi të pavarur

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të krijojë dhe të respektojë mendimin e tij të pavarur. Për këtë, nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë ndryshimet që ekzistojnë në mendimin filozofik;
- të shpjegojë pse njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme;
- të dallojë lidhjen e pikëpamjeve të ndryshme me interesa të ndryshme ekonomike, politike, fetare etj.;
- të formulojë pikëpamjen e tij dhe të argumentojë pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik.

Respektimi i diversitetit

Nxënësi duhet të jetë në gjendje:

- të dallojë vlerat pozitive edhe në rrymat filozofike, mendimet e pikëpamjet me të cilat nuk është dakord;
- të argumentojë që çdo mendim, pra edhe mendimi i tij, është i kufizuar nga koha dhe vendi, nga interesat, arsimimi, përkatësia ekonomike, shoqërore etj.;
- të tregojë pse të tjerët duhet të pranojnë mendimin e tij filozofik, për të kuptuar pse ai duhet të pranojë pikëpamjet e të tjerëve;
- të pranojë mendimin e tij dhe të tjetrit si mendime plotësuese në tablonë e përgjithshme të mendimit njerëzor të epokës.

PËRMBAJTJA

Temat	Përmbajtja e linjës (autorë, koncepte, probleme)
Tema 1. Periudha helenike	<ul style="list-style-type: none"> - Hyrje e shkurtër në të cilën të përshkruhen rrethanat historiko–shoqërore të lindjes së filozofisë së kësaj periudhe dhe veçoritë më të përgjithshme të kohës, veçanërisht lidhja e mitit me shkencën dhe ndikimi që ato kanë pasur në mendimin dhe praktikën e kohës. - Filozofia Parasokratike. - Sofistët dhe Sokrati. - Platoni”: dialektika platonike, reminishenca dhe miti, filozofia dhe politika, drejtësia. - Aristoteli: logjika, metafizika, morali, politika.
Tema 2. Periudha romake	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të periudhës romake, që përcaktuan daljen e drejttimeve të mëposhtme filozofike. - Stoicizmi: origjina e stoicizmit, racionalizmi stoik, logjika, fizika, psikologjia, morali. - Epikurianizmi: kanonika, fizika, morali. - Skepticizmi.
Tema 3. Drejtimit filozofike në shekujt e parë të erës sonë	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës, sidomos i skepticizmit në epokën perandorake. - Seneka; stoicizmi i epokës perandorake, morali, individi dhe bota. - Mark Aureli; morali, mësimi i filozofisë, individi dhe universi. - Neoplatonizmi (Plotini, Porfirri).
Tema 4. Mesjeta dhe Rilindja	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës, e veçanërisht i atyre që trajtojnë marrëdhëniet e arsyes dhe të besimit, që përcaktuan këtë tip të mendimit filozofik në këtë periudhë. - Arsyeja dhe besimi. - Shën Agustini; teologjia dhe arsyeja, morali, qyteti i Zotit dhe qyteti tokësor. - Thoma Akuini; arsyeja dhe besimi, teoria e njohjes, provat e ekzistencës së Zotit, përshtatja e Aristotelit në funksion të teologjisë së krishterë

	<ul style="list-style-type: none"> - Avicena: teologjia myslimane, ndikimi i Aristotelit dhe neoplatonizmit, morali, teoria e njohjes. - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme të epokës së Rilindjes. - Averroes: komentimi i Aristotelit, teoria e intelektit. - Montenji: pirroizmi i tij, morali dhe politika. - Kampanela: utopia.
<p>Tema 5. Shekulli XVII</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historiko – shoqërore që përcaktuan daljen e racionalizmit dhe të empirizmit dhe ndikimi i tyre në problematikën filozofike dhe në mendimin e kohës. - Frensis Bekon; kuptimi dhe shkencat eksperimentale, Organoni i Ri, - Dekarti dhe racionalizmi; metoda, trupi dhe shpirti. - Spinoza; reforma e mendimit, natyra njerëzore, liria dhe jeta e domosdoshmëria. - Hobsi; gjendja natyrore dhe kontrata shoqërore - Xhon Loku; teoria e njohjes, politika, idetë.
<p>Tema 6. Shekulli XVIII</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historiko – shoqërore të shekullit që përcaktoi problemet e mëdha filozofike të kohës. Filozofia e shekullit XVIII si pararendëse e lëvizjeve të mëdha në Evropë drejt një shoqërie më të mirë dhe më të lirë. - Monteskjë; natyra e ligjeve, ndarja e pushteteve, determinizmi gjeografik. - David Hjum ; teoria e njohjes, kritika e fesë, morali dhe politika. - Enciklopedistët francezë (Didëro, d’Alamber, Holbah, Helvetius). - Volteri; teoria e natyrës, njeriu dhe historia, toleranca. - Rusoi; kontrata, liria, natyra njerëzore. - Kanti dhe filozofia e tij kritike; arsyeja, teorike dhe praktike, feja, e drejta, aftësia e gjykimit.

<p>Tema 7. Shekujt XIX dhe XX</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Përshkrimi i karakteristikave të përgjithshme historike që përcaktuan sistemet e mëdha filozofike. Kritika e tyre. Pikënisjet për drejtimit bashkëkohore të filozofisë. - Utilitarizmi anglez: (Bentam) morali, e drejta. - Xhon Stjuart Mill; logjika, shkencat morale dhe morali - Hegeli; Dialektika, e drejta, historia. - Marks; materializmi, historia, politika, ateizmi. - Fridrih Niçe; kritika e vlerave, mbinjeriu, ateizmi. - Kirkegard; individi, ekzistenca. - Disa drejtim dhe probleme të filozofisë bashkëkohore. - Henri Bergson; doktrina e njohjes, problemi i kujtesës, njeriu, natyra dhe funksioni i inteligjencës në raport me jetën. - Haideger; njeriu, ontologjia, ankthi. - Sartri; ekzistenca, liria, ateizmi. - Xhon Dju; etika, edukimi, shoqëria. - Vitgenshtajn dhe filozofia analitike; gjuha dhe përvoja, qëllimi i filozofisë, struktura logjike e gjuhës dhe bota. - Psikoanaliza dhe filozofia (Frojd, From). - Hermenautika, Strukturalizmi dhe poststrukturalizmi (postmodernizmi).
--	---

PESHA SIPAS TEMAVE

Nr.	Tema	Pesha (në përqindje)
1.	Periudha helenike	- 15%
2.	Periudha romake	- 10%
3.	Drejtimet filozofike në shekujt e parë të erës sonë	- 5%
4.	Mesjeta dhe Rilindja	- 15%
5.	Shekulli XVII	- 15%
6.	Shekulli XVIII	- 15%
7.	Shekujt XIX dhe XX	- 25%